



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 53, Datë 02.04.2024

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GLOBAL  
TECHNICAL MECHANICS” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, date 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 809/1prot., datë 29.03.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 809, datë 21.03.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Nga ky aplikim rezulton se shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores, dokumentacion i cili konsiderohet thelbësor, ndaj vlerësohet mos fillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10 pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të

munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Aplikuesi mund të paraqesë pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**